

## Syllabusi i lëndës: Psikologji e familjes

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti Filozofik – Departamenti i Psikologjisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	Psikologji e familjes
<b>Niveli:</b>	Master
<b>Statusi i lëndës:</b>	Zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	I
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 + 1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5
<b>Koha / lokacioni:</b>	Për t'u definuar
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Ass. Dr. Dashamir Bërxulli
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:dashamir.berxulli@uni-pr.edu">dashamir.berxulli@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kjo lëndë ofron një pasqyrë ekzaminimesh të pikëvështrimeve teorike dhe praktike mbi familjen. Gjithashtu, lënda do të përqendrohet në çështje kryesore të lidhura me familjen si martesë, zhvillimi i familjes, ndikime kulturore mbi familjen, mënyrat e rritjes së fëmijëve, disfunkcionet në familje dhe familje me situata në veçanta.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllim i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi të gjykimit analitik dhe kritik mbi identitetin kombëtar, nacionalizmin, teoritë kryesore lidhur me to, dukuritë që kanë shkaktuar shfaqjen e tyre, trajtat e zhvillimit të tyre pas shfaqjes, si dhe mbi manifestimet dhe pasojat e ndryshme të kombit dhe të nacionalizmit në ditët e sotme.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi i njohurive mbi teoritë dhe metodat për të kuptuar martesën dhe ndërveprimet familjare;</li> <li>• Pajisja me njohuri mbi çështje të ndryshme të zhvillimit të familjes;</li> <li>• Ilustrimi e problemeve tipike dhe zgjidhje të caktuara për problemet familjare;</li> <li>• Zbërthimi i problemeve të familjes në Kosovë dhe ndryshimet strukturore të saj pas luftës;</li> <li>• Nxitja e mendimit kritik lidhur me çështje të martesës dhe ndërveprimit familjar.</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			1
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim			6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			1
Projektet,prezentimet ,etj			2
<b>Totali</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërimit 50%; Diskutim me studentët 20%; Diskutimet e studentëve mes vete 15% Konsultime mbi lëndën dhe mbi punimin seminarik 15% Përqindjet e dhëna më sipër janë të synuara dhe të përafërta; varësisht nga prirjet e studentëve dhe nga perceptimi i mësimdhënësit mbi mundësitë për të bërë një punë optimale, këto përqindje mund të pësojnë ndryshime të lehta.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi dhe konsultimet e rregullta: 10% Punimi seminarik: 30% Provimi final: 60%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	Bray, J. & Stanton, M. (2009). <i>Family Psychology</i> . The Wiley Blackwell. ISBN: 978-1-4051-6994-3.		
<b>Literatura shtesë:</b>	Pinsolf, W. M., & Lebow, J. L. (2005). <i>Family Psychology: The Art of the Science</i> . Oxford University Press.		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në lëndë
<i>Java e dytë:</i>	Psikologjia e marrëdhënieve të ngushta
<i>Java e tretë:</i>	Trende aktuale në marrëdhëniet e ngushta (shikim i veçantë në Kosovë)
<i>Java e katërt:</i>	Shëndeti mental dhe familja
<i>Java e pestë:</i>	Teori dhe korniza teorike mbi familjen
<i>Java e gjashtë:</i>	Vlerësimi psikologjik i çifteve dhe familjes
<i>Java e shtatë:</i>	Mbështetja sociale dhe familja
<i>Java e tetë:</i>	Ndikimi i faktorëve kognitivë dhe të tjerë në jetën martesore
<i>Java e nëntë:</i>	Intimiteti dhe ndikimi i tij në jetën martesore
<i>Java e dhjetë:</i>	Komunikimi ndërpersonal: Zgjidhja e konflikteve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Probleme në familje dhe në çift: mungesa e besnikërisë dhe dhuna familjare
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Prindërimi i fëmijëve dhe adoleshentëve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Terapia me familje
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Parandalimi i problemeve në familje
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përmbledhje

<b>Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënësi do të ndihmojë të nxënit e studentëve dhe arritjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm;</li> <li>- Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore;</li> <li>- Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet;</li> <li>- Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimdhënësit;</li> <li>- Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;</li> </ul>